


# Histori Suksesi

## Punonjësit e Qendrave Shëndetsore Identifikues të Viktimave të Mundshme të Trafikimit

Njësitë Lëvizëse Tiranë dhe Shkodër, struktura të Organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë” ofrojnë një sërë shërbimesh dhe aktivitete në terren dedikuar identifikimit të rasteve të trafikimit.



Një tregues i arritjeve të përpjekjeve të Njesisë së Lëvizshme ka qenë fakti që për herë të parë Qendrat Shëndetësore janë mobilizuar kundër fenomenit për të raportuar dhe referuar raste në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Gjatë periudhës Janar - Shkurt 2021, Njësia Lëvizëse Shkodër ka zhvilluar njëmbëdhjetë takime me stafet e Qendrave Shëndetësore duke i informuar rreth treguesve që lidhen me këtë fenomen.

Këto struktura shëndetsore kanë rezultuar burime shumë të rëndësishme pasi vetëm nga një prej Qendrave Shëndetësore të Bashkisë Shkodër janë identifikuar 3 raste viktime të mundshme të trafikimit. Një tregues ky i mobilizimit kundrejt fenomenit duke raportuar dhe referuar raste lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Punonjësit e këtyre qendrave shprehin dëshirën për t’i ndihmuar personat në rrezik trafikimi, sidomos në rastet kur mungon informacioni i nevojshëm për mundësitë e rehabilitimit të tyre.



Në punën e përditshme të Njësive Lëvizëse konsiderohet i rëndësishëm bashkëpunimi me institucionet vendore dhe me përfaqësues të komuniteteve të cilët kanë informacion rreth banorëve në zonat ku ata jetojnë. Përveç Qendrave Shëndetësore takime informuese dhe sensibilizuese janë organizuar me Shërbimin Social, qendrat komunitare, punonjës dhe nxënës të shkollave, komunitetin Egjiptian dhe ndërlidhësit e komunitetit.

